



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ Prot.

Prrenjas, më ____ . ____ 2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT

Data 26.08.2026

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) VIANTE Konstruksion shpk 80% dhe LLAZO SHPK 20%, përkatësisht VIANTE Konstruksion shpk me nr.Nipt K47103804L, me adresë: Elbasan Gramsh GRAMSH SPORTI, me administrator Z.Gjergji Bezati dhe LLAZO SHPK me nr.NIPT K24218401K, me adresë: Fier Lushnje BISHQETHEM Bishqethem, Bishqethem 1, Rruga Kemishtaj, zona kadastrale 1197, nr pasurie 3/21, me administrator ZAldi Llazi.

- **OE/BOE me nënkontraktor**

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

- **OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-92676-07-07-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës,faza IV,Bashkia Prrenjas”

Fondi limit: 69,303,996 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e treqind e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 09.07.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [Data 13.07.2026]
[Numri 45]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik K.M.K Shpk, me nr. Nipt **L78223801E** me adresë: Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/Ndertese me administrator Z. Kelmend Caushaj me ofertë ekonomike me vlerë **50,194,115** (pesedhjetë e kater milion e njeqind e nentendhjetë e kater mije e njeqind e pesembedhjetë) leke 60,232,938 (gjashtedhjetë milion e dyqind e tridhjetë e dy mije e nenteqind e tridhjetë e tete) leke me tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori ekonomik LIS KONSTRUKSION SHPK me nr. NIPT K66613407H me adresë: Diber Bulqize Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15. me administrator Znj. Dorian Murati, me ofertë ekonomike me vlerë: 69,300,000 (gjashtedhjetë e nentemilion e treqind mije) leke pa tvsh dhe 83,160,000 (tetedhjetë e tre milion e njeqind e gjashtedhjetë mije) leke me tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë VIANTE Konstruksion shpk 80% dhe LLAZO SHPK 20%, përkatësisht VIANTE Konstruksion shpk me nr.Nipt K47103804L, me adresë: Elbasan Gramsh GRAMSH SPORTI, me administrator Z.Gjergji Bezati dhe **LLAZO SHPK** me nr.NIPT K24218401K, me adresë: Fier Lushnje BISHQETHEM Bishqethem, Bishqethem 1, Rruga Kemishtaj, zona kadastrale 1197, nr pasurie 3/21, me administrator Z.Aldi Llazi dhe ofertë ekonomike me vlerë 67,210,817.94 (Gjashtëdhjetë shtatë milion e dyqind e dhjetë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë pike nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe 80,652,981.53 (Tetëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pike pesëdhjetë e tre) lekë me tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Operatori ekonomik ALBAVIA shpk, me nr. Nipt J8152700Q, me adresë: Rruga “Sulejman Delvina”, Pall Fati, Ap.19 Kodi 1001, Tiranë me administrator Z.Shkelqim Rakipaj me ofertë ekonomike me vlerë: 59,328,512.50 (Pesëdhjetë e nëntë milion e treqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh dhe 71,194,215 (shtatëdhjetë e një milion e njëqind e nëntëdhjetë katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë me tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. Operatori ekonomik BIBA-X shpk, me nr.Nipt K32618815N, me adresë: Tirane Lekaj HARIZAJ Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50m prane Karburant "EURODRIN", me administrator Z.Skënder Biba me oferte ekonomike me vlerë **59,301,823 (Pesedhjet e nente milion e trqind e nje mije e teteqind e njezet e tre) leke pa TVSH dhe 71,162,187 (Shtatedhjet e nje milion e njëqind e gjashtedhjet e nje mije e njeqind e tetedhjet e shtate) lek me tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. Operatori ekonomik TREND & CO SHPK me nipt M01910011O me adresë: Tirane Tirane Tirane, Shkoze, Rruga “Marie Kraja“ Njesia nr.3 , Nr.Pasurie 42/34-ND Zk.3976, me administrator Z.Ermal Keco me ofertë ekonomike me vlerë 69,201,220 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e dyqind e një mijë e dyqind e njëzetë) leke pa tvsh dhe 83,041,464 (tetëdhjetë e tre milion e dyzet e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë katër) leke me tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1.OE ALBAVIA shpk, me nr. Nipt J8152700Q, me adresë: Rruga “Sulejman Delvina”, Pall Fati, Ap.19 Kodi 1001, Tiranë me administrator Z.Shkelqim Rakipaj me ofertë ekonomike me vlerë: 59,328,512.50 (Pesëdhjetë e nëntë milion e treqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë pa tvsh dhe 71,194,215 (shtatëdhjetë e një milion e njëqind e nëntëdhjetë katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë me tvsh.

Arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE u konstatua se :

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e veçanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

Arsyet e skualifikimit janë si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi,

rezulton se nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht:

- ❖ **Operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK ka paraqitur preventivin e punimeve nga verifikimi i të cilit rezulton se sasia e ofertuar për zërin nr.1 është ndryshuar.**

Preventivi i publikuar nga Autoriteti Kontraktor:

1. Prerje bimë të vogla $\tilde{\varnothing} \sim 10$ cm m2 10000
- Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik:
1. Prerje bimë të vogla $\tilde{\varnothing} \sim 10$ cm m2 1000

Nga verifikimi i preventivit rezulton se ka devijime dhe gabime në përcaktimin e sasive të zërave të përcaktuara në DT.

Nuk ka paraqitur sasinë e duhur sipas zërave të preventivit të hartuar/miratur në DT, gjë që vjen në kundërshtim me Shtojcën Nr. 2 në DT, “Lista e Çmimeve sipas zërave të preventivit”, si dhe me Shtojcën Nr. 1, “Formulari i Ofertës Ekonomike”, germa “d”; Seksioni I: “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, të DT.

Në rastin konkret, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik **ALBAVIA sh.p.k.** ka ndryshuar strukturën e preventivit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi ka ulur sasinë e zërave konkretë të tij.

Konkretisht:

Preventivi i publikuar nga Autoriteti Kontraktor:

1. Prerje bimë të vogla $\tilde{\varnothing} \sim 10$ cm m2 10000

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik:

2. Prerje bimë të vogla $\tilde{\varnothing} \sim 10$ cm m2 1000

Komisioni gjykon se, në rastin konkret, jemi në kushtet e **ndërhyrjes në sasinë e preventivit**, pasi operatori ekonomik ka ndryshuar sasinë e përcaktuar në preventivin e hartuar dhe miratur nga Autoriteti Kontraktor.

- Operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK ka ulur me 9000 njësi sasinë për zërin me numër 1 në kundërshtim me:

Nenin **91, pika 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar**, i cili përcakton përcakton se Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij **ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën**. Nenin **92, pika 1, 2 dhe 3** i cili përcakton se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, **nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.***

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, **duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike**, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

- Mundësia e parashikuar në **nenin 92, pika 2**, për korrigjimin e gabimeve aritmetike, nuk mund të shtrihet në ndryshimin e sasive të zërave të preventivit. Korrigjimi i një gabimi aritmetik nënkupton korrigjimin e një pasaktësie matematikore në përlllogaritje, dhe jo ndryshimin e të dhënave të ofertës, të sasive të punimeve apo të përmbajtjes së preventivit.

Në rastin konkret, ndryshimi i sasive të zërave të preventivit përbën **ndryshim të përmbajtjes së ofertës**, pasi operatori ekonomik ka paraqitur një ofertë për një volum punimesh të ndryshëm nga ai i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Vlen të përmendim këtu edhe praktikën Komisionit të Prokurimit Publik i cili me vendimin nr.241/2018 arsyeton :

*KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar **të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme**. KPP gjykon se, zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë se, operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik BOE “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. ka ndryshuar strukturën e preventivit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi ka shtuar ose ulur sasi të zërave konkretë të tij. Komisioni gjykon se, nuk jemi në kushtet e mospërputhjes të cmimit për njësi me cmimin total, apo mospërputhjes ndërmjet fjalëve dhe shifrave, të parashikuara në nenin 66, pika 4 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasi të preventivit. Neni 51 i ligjit të prokurimit publik, **nuk e lejon autoritetin kontraktor të modifikojë ofertën, duke ndryshuar sasi të zërave të punimeve në preventiv**. Gjithashtu sic parashikohet në nenin 53, pika 1 të këtij ligji, nga ana e autoritetit kontraktor **nuk mund të lejohet ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme**.*

❖ **Operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK ka paraqitur një deklaratë ku deklaron se:**

Punonjësit me initiale XH.T, Q.B, K.L me profesion Betonues, punonjësi me initiale A.V me profesion Hekurthyes dhe punonjësi me initiale A.Gj me profesion Karpentier rezultojnë të jenë të pajisur me certifikatë/ diplomë nga shoqëria “HTM” SHPK shoqëri e cila rezulton të jetë e licensuar për “Çertifikim personeli elektrik që punojnë në tensione të ulta, të mesme dhe të larta”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 77, 87,92 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik”i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të Tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e **“ALBAVIA” SHPK** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme**.

2.Operatori ekonomik **“BIBA-X” shpk**, me nr.Nipt K32618815N, me adresë: Tirane Lekaj HARIZAJ Fshati Kryeluzaj, Pika Inerte 50m prane Karburant "EURODRIN", me administrator Z.Skënder Biba me oferte ekonomike me vlerë **59,301,823 (Pesedhjet e nente milion e trqind e nje mije e teteqind e njezet e tre) leke pa TVSH dhe 71,162,187 (Shtatedhjet e nje milion e njëqind e gjashtedhjet e nje mije e njëqind e tetedhjet e shtate) lek me tvsh.**

Arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE u konstatua se :

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta te Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

❖ **Operatori ekonomik “BIBA-X” shpk ka paraqitur preventivin e punimeve nga verifikimi i të cilit rezulton se sasia e ofertuar për zërin nr.19 është ndryshuar.**

Preventivi i publikuar nga Autoriteti Kontraktor:

19. F.V Hekur betoni periodik $\bar{O} > 12\text{mm}$ (Për murin me gjerësi 2 m që do kalojë trotuarin)
Ton 0.33019

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik:

19. F.V Hekur betoni periodik $\bar{O} > 12\text{mm}$ (Për murin me gjerësi 2 m që do kalojë trotuarin)
Ton 0.33018

- Operatori ekonomik **“BIBA-X” shpk** ka ndryshuar sasinë për zërin me numër 19 në kundërshtim me:

Nenin **91, pika 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar**, i cili përcakton përcakton se Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ***ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.***

- Nenin **92, pika 1, 2 dhe 3** i cili përcakton se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të

lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

- Mundësia e parashikuar në **nenin 92, pika 2**, për korrigjimin e gabimeve aritmetike, nuk mund të shtrihet në ndryshimin e sasive të zërave të preventivit. Korrigjimi i një gabimi aritmetik nënkupton korrigjimin e një pasaktësie matematikore në përlogaritje, dhe jo ndryshimin e të dhënave të ofertës, të sasive të punimeve apo të përmbajtjes së preventivit.

Në rastin konkret, ndryshimi i sasive të zërave të preventivit përbën **ndryshim të përmbajtjes së ofertës**, pasi operatori ekonomik ka paraqitur një ofertë mbi një volum punimesh të ndryshëm nga ai i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Vlen të përmendim këtu edhe praktikën e Komisionit të Prokurimit Publik i cili me vendimin nr.241/2018 arsyeton :

*KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar **të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme**. KPP gjykon se, zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë se, operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik BOE “Dimension Construction” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. ka ndryshuar strukturën e preventivit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, pasi ka shtuar ose ulur sasi të zërave konkretë të tij. Komisioni gjykon se, nuk jemi në kushtet e mospërputhjes të cmimit për njësi me cmimin total, apo mospërputhjes ndërmjet fjalëve dhe shifrave, të parashikuara në nenin 66, pika 4 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, por jemi në kushtet e ndërhyrjes në sasi të preventivit. Neni 51 i ligjit të prokurimit publik, **nuk e lejon autoritetin kontraktor të modifikojë ofertën, duke ndryshuar sasi të zërave të punimeve në preventiv**. Gjithashtu sic parashikohet në nenin 53, pika 1 të këtij ligji, nga ana e autoritetit kontraktor **nuk mund të lejohet ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme**.*

❖ Njëpërmjet FORMULARIT PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT pika B.DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik, të paraqitur në SPE, operatori ekonomik “BIBA-X” shpk ka deklaruar se do të mbështetet në kapacitetet e operatorit “PE-VLA-KU”shpk për sa më poshtë:

1. Licensa Profesionale PIKA NS-18 B
4. KODI III.2.B

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton se Operatori Ekonomik “BIBA-X” shpk nuk përmbush kriterin:

- 2.3.2 Licensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës • N.S.-18 (Punime topogjeodezike) Niveli B, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit dhe
- 2.3.10 b) Operatori Ekonomik duhet të jete i licensuar nga QKB me Kodin III.2.B "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis"-Veprimtarite e tjera

profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis - Grumbullim dhe transport i mbetjeve te Ngurta(Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve inerte), se bashke me Akt Miratimin me kodet 17 01 01; 17 01 02; 17 01 03; 17 01 07; 17 04 07; 17 05 04; 17 05 06; 17 05 08; 17 09 04; në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Për kategoritë, NS-18 dhe Licencë me KODIN III 2 B operatori ka vetëdeklaruar se do të mbështetet në kapacitetet e subjektit **“PE-VLA-KU”shpk.**

Në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, në nenin 8, pika 1 përcaktohet qartë se:

“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendës apo

të huaj, të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore.”

Gjithashtu, sipas VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, në kreun III, lidhur me kategorizimin dhe klasifikimin e licencave ndërtimore, theksohet se: “Licenca është dokument juridik dhe profesional që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar ndërtimore, sipas

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;

- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;

- Kapacitetet financiare

Për më tepër, në VKM nr. 448, datë 31.07.2025, "Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Punimeve të Ndërtimit dhe të Rregullave të Kantierit", në nenin 6, përcaktohet se:

“Çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi vetëm për kategoritë e punimeve që ka të përcaktuara në licencë.”

Në të njëjtën linjë, neni 7 i së njëjtës VKM, thekson se: “Zbatuesi i punimeve duhet të jetë vetë i licencuar për veprimtarinë përkatëse.”

Nga interpretimi i dispozitave ligjore sektoriale që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë ndërtimore,

del qartë se një subjekt juridik nuk mund të zbatojë apo realizojë punime ndërtimi

jashtë kategorive dhe nivelit që ka të përcaktuar në licencën e tij, të lëshuar nga Ministria përgjegjëse

për zhvillimin e territorit (aktualisht MIE).

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, si dhe VKM nr. 42/2008, përcaktojnë qartësisht se kategoritë e licencës nuk janë të transferueshme apo të “huazueshme” nga një subjekt në një tjetër. Ato fitohen vetëm nëpërmjet plotësimit të kriterëve të caktuara për përvojë, kapacitete teknike, financiare dhe drejtues teknikë të kualifikuar.

Nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që parashikon mbështetjen në licencën ndërtimore të një subjekti

tjetër. Një interpretim i tillë do të sillte në praktikë anashkalimin e rolit të Komisionit të Dhënies së

Licencave prane MIE , që është autoriteti kompetent për verifikimin dhe lëshimin e licencave ndërtimore sipas kategorive të përcaktuara.

Forma e vetme e lejuar për të bashkuar kapacitetet ne kategorite apo nivelin e licences , është krijimi

i një Bashkimi Operatorësh Ekonomikë (BOE).

Lidhur me këtë çështje **Komisioni i Prokurimit Publik** me Vendimin Nr.586/2019 arsyeton:

*KPP gjykon se plotësimi i kërkesave për kualifikim në një procedurë prokurimi shtrihet strictu sensu vetëm ndaj operatorëve pjesëmarrës dhe në asnjë rast, operatorët ekonomikë pjesëmarrës nuk mund të përmbushin kapacitetet teknike me anë të dokumentacionit të subjekteve të tjerë juridikë. Dorëzimi i dokumentacionit të një subjekti tjetër i cili nuk është pjesëmarrës në procedurën e prokurimit dhe as nuk shfaqet në cilësinë e njërit prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve nuk mund të konsiderohet i vlefshëm duke u paraqitur si dokumentacion i vetë pjesëmarrësit. KPP gjykon sese përdorimi i kapacitetit teknik të subjekteve të tjerë juridikë në kuadër të përfitimit të fondeve publike referuar ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar, **pranohet në rastet e paraqitjes së ofertës në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë në zbatim të nenit 74 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"** të ndryshuar.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 " Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 77, 87,92 të Ligjit 162/2020, "Për Prokurimin publik"i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të Tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e **"BIBA-X" shpk** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

3. Operatori ekonomik "K.M.K" Shpk, me nr. Nipt L78223801E me adresë: Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/Ndertese me administrator Z. Kelmend Caushaj me ofertë ekonomike me vlerë **50,194,115** (pesedhjetë e kater milion e njeqind e nentëdhjetë e kater mije e njeqind e pesëmbëdhjetë) leke 60,232,938 (gjashtëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e dy mije e nentëqind e tridhjetë e tete) leke me tvsh.

Arsyet e mëposhtme:

Nga përlllogaritja me formulë rezulton se oferta është anomalisht e ulët.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

1. Referuar sa më sipër dhe në mbështetje të Nenit 93, Pika 5 e Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, ku citohet se: "Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: "5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët",

Për këtë arsye oferta refuzohet.

4.Operatori ekonomik "TREND & CO" SHPK me nipt M01910011O me adresë: Tirane Tirane Tirane, Shkoze, Rruga "Marie Kraja" Njesia nr.3 , Nr.Pasurie 42/34-ND Zk.3976, me administrator Z.Ermal Keco me ofertë ekonomike me vlerë 69,201,220 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e dyqind e një mijë e dyqind e njëzetë) leke pa tvsh dhe 83,041,464 (tetëdhjetë e tre milion e dyzet e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë katër) leke me tvsh.

Arsyet e mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE u konstatua se :

- Nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk plotëson kriteret e veçanta të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar për kualifikim, të përcaktuara në DT.
- Nuk plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin Elektronik të Prokurimit rezulton se Operatori Ekonomik **“TREND & CO” SHPK nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas**

KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT të përcaktuara në DST, konkretisht:

- ❖ **Nuk ka paraqitur** Sigurimin e Ofertës, sipas *Shtojcës 3 dhe* Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 në kundërshtim me pikën 1 a) dhe b) të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Mosplotësimi i këtij kriteri është në kundërshtim me nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, sipas të cilit Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit paraqitet së bashku me ofertën si provë paraprake, si dhe me nenin 83 të të njëjtit ligj, i cili parashikon detyrimin e autoritetit kontraktor për kërkimin e sigurimit të ofertës, përveç rasteve të procedurave me vlerë të vogël, si dhe me nenet 26 dhe 30 të VKM të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- ❖ **Nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar përmbushjen e kriterit për punë të ngjashme.** Ka paraqitur vetëm dy fatura shitje me subjektin DESARET COMPANY shpk, në kundërshtim me pikën 2.3.1 a) dhe b) të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

- ❖ Në licencën **profesionale të paraqitur mungojnë kategoritë:**

N.P-12 (Punime të inxhinjerise se mjedisit)

Niveli A

N.S.-18 (Punime topogjeodezike)

Niveli B

Në kundërshtim me pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

- ❖ **Nuk ka paraqitur dokumentacion për përmbushjen e pikes 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.8, 2.3.10, 2.3.11 të kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST.**

Për rrjedhojë, mungesa e këtyre dokumenteve nuk përbën një mangësi thjesht formale, por prek drejtpërdrejt përmbushjen e kushteve të pjesëmarrjes në procedurë.

Në nenin 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se :

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Referuar dokumentave standarte të tenderit “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.....”

Sa me siper pjesmarrja e Operatorit ekonomik **“TREND & CO” SHPK** konsiderohet e parregullt ne te gjithë elementet e saj, ne kundershtim dhe me shtojcen 8 Formular i Kriterëve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit Kriteret E Përgjithshme Të Përzgjedhjes/ Kualifikimit dhe Kriteret e Vecanta te Kualifikimit te dokumentave standarte te tenderit .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 77, 87,92 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik”i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të Tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **“TREND & CO” SHPK** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pa vlefshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë **VIANTE Konstruksion shpk** 80% dhe **LLAZO SHPK** 20%, përkatësisht **VIANTE Konstruksion shpk** me nr.Nipt K47103804L, me adresë: Elbasan Gramsh GRAMSH SPORTI, me administrator Z.Gjergji Bezati dhe **LLAZO SHPK** me nr.NIPT K24218401K, me adresë: Fier Lushnje Bishqethem, Bishqethem 1, Rruga Kemishtaj, zona kadastrale 1197, nr pasurie 3/21, me administrator ZAldi Llazi dhe ofertë ekonomike me vlerë 67,210,817.94 (Gjashtëdhjetë shtatë milion e dyqind e dhjetë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë pike nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe 80,652,981.53 (Tetëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pike pesëdhjetë e tre) lekë me tvsh, është identifikuar si ofertues i sukseshëm. Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

Konceptoi: A.Kopaçi
Pranoi : M.Rira

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA

ME URDHËR DHE DELEGIM
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
ZAMIRA ÇEKREZI